

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj kryetar, Raima Elezi e Teuta Krusha anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Birsen Kume, duke vendosur në lëndën penale ndaj të akuzuarve M<sup>1</sup> P<sup>2</sup>, M<sup>3</sup> B<sup>4</sup> dhe Sh<sup>5</sup> B<sup>6</sup> që të gjithë nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge në bashkëkryerje nga neni 273/1 lidhur me nenin 31 të KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.25/2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datën 09.02.2017 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarit M<sup>1</sup> P<sup>2</sup> mbrojtësit të tij Av.A. H<sup>3</sup>, të akuzuarit M<sup>3</sup> B<sup>4</sup>, mbrojtësit të tij av.B<sup>7</sup> N<sup>8</sup> si dhe të akuzuarit Sh<sup>5</sup> E<sup>9</sup> mbrojtësit të tij av.R<sup>10</sup> K<sup>11</sup>, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## AKT GJYKIM

Të akuzuarit:

1.M<sup>1</sup> P<sup>2</sup>, nga i ati M<sup>3</sup> B<sup>4</sup> dhe e ëma E<sup>5</sup>, e vajzërisë B<sup>6</sup>, i lindur me datën 02.02.1981, në Prizren, ku edhe tanë banon në Rr. ” ” pn, ka të kryer shkollën fillore punëtor i ndërtimtarisë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.M<sup>1</sup> B<sup>2</sup>, nga i ati A<sup>3</sup> dhe e ëma F<sup>4</sup>, e vajzërisë V<sup>5</sup>, i lindur me në fshatin Komuna e Prizrenit, tanë me banim në Prizren në rrugën ” ” pn, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, i pa punë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

3.SH<sup>1</sup> B<sup>2</sup>, nga i ati E<sup>3</sup> dhe e ëma F<sup>4</sup>, e vajzërisë B<sup>5</sup>, i lindur me datën 15.02.1981 në Prizren ku edhe tanë jeton në rrugën ” ” , ka të kryer shkollën fillore, nxënës, beqar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I.

Në mbështetje të nenit 364 pika 1.3 të KPP-së.

## LIROHEN NGA AKUZA

Të akuzuarit M<sup>1</sup> B<sup>2</sup> dhe Sh<sup>5</sup> B<sup>6</sup>

Sepse me datë 22.02.2015 rreth orës 00:05 minuta të mesnatës, në rrugën lokale Prizren-Nashec, të pandehurit me marrëveshje paraprake me njëri tjetrit, pa autorizim posedojnë me qëllim të shitjes apo shpërndarjes dhe ofrimit për shitje substancën e dyshuar për narkotik të llojit marijuan, në atë mënyrë që me datën 21. Shkurt 2015 që të tre të pandehurit takohen, i pandehuri M<sup>1</sup> P<sup>2</sup> nerr nga i pandehuri M<sup>3</sup> B<sup>4</sup> automjetin e markës Opel Kadet, me targa të regjistrimit , pronë e të pandehurit M<sup>1</sup> B<sup>2</sup>, në bagazhin e të cilët automjete kanë qenë të vendosura dymbëdhjetë (12) qese plastike të përmasave të ndryshme në brendësinë e të cilave kishte 167,39 gram substancë narkotike të llojit marijuanë, i pandehuri Sh<sup>5</sup> B<sup>6</sup> e furnizon automjetin me karburant, nisen së bashku më të

pandehurin M. P. për në fshatin pastaj kthehen në Prizren; prej Prizrenit nisen në Gjakovë dhe prej Gjakove në Graçanicë, pasi që të kthehen nga Graçania, derisa ishin duke udhëtuar në drejtëm të fshatit Nashec, nëpër rrugën e vjetër të tranzitit ndalohen nga policia, ku pas kontrollit të policisë në bagazhin e automjetit policia gjen dhe sekuestron substancën narkotike në vlerë të përgjithshme prej 167, 39 gram, e të cilën substancë që të tre të pandehurit e kanë poseduar, transportuar dhe ofruar për shitje pa autorizimin e organit kompetent.

Kësot dore do të kryenin veprën penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge në bashkëkryerje nga nen 273/1 lidhur me nenin 31 të KP-

- Për shkak se nuk është provuar që të akuzuarit M. B. dhe Sh. B. të kenë kryer këtë vepër penale.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## II.

### ËSHTË FAJTORË

I akuzuari M. P.

Sepse me datë 22.02.2015 rrëth orës 00:05 minuta të mesnatës, në rrugën lokale Prizren-Nashec, pa autorizim posëdon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes dhe ofrimit për shitje substancën e dyshuar për narkotik të llojit marijuan, në atë mënyrë që me datën 21. Shkurt 2015 i pandehuri M. P. merr nga M. B. automjetin e markës Opel Kadet, me targa të regjistrimit , në bagazhin e të cilit automjete ka vendosur dy mbëdhjetë (12) qese plastike të përmasave të ndryshme në brendësinë e të cilave kishte 167,39 gram substancë narkotike të llojit mariuanë, niset për në fshatin Gjonaj të Hasit, pastaj kthehet në Prizren, prej Prizrenit niset për në Gjakovë dhe prej Gjakove në Graçanicë, pasi që të kthehet nga Graçanica, derisa ishte duke udhëtuar në drejtëm të fshatit Nashec, nëpër rrugën e vjetër të transitit ndalohen nga policia, ku pas kontrollit të policisë në bagazhin e automjetit policia gjen dhe nga i akuzuari sekuestron substancën narkotike në sasi të përgjithshme prej 167,39 gram, e të cilën substancë e ka poseduar, transportuar dhe ofruar për shitje pa autorizimin e organit kompetent.

-Kësot dore ka kryer veprën penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga nen 273 par.1 të KP-së.

Gjykata në kuptim të dispozitave së lartshënuara dhe neneve: 4, 7, 41, 42, 43, 45, 46, 73 dhe nenit 273 par. 1 të KP, të akuzuarin e:

### G J Y K O N

Me dënim me gjobë në lartësi prej 2000 (dymijë) eurove, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i njëjti nuk mundet apo nuk dëshiron të paguaj gjobën dënimini me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim, dhe

-Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.02.2015 deri më datën 06.03.2015.

Në pajtim me nenin 275 paragrafi 5 të KP konfiskohet narkotiku në sasi prej 167.39 gram i llojit marijuanë dhe automjeti “Opel Kadet” me tabela të regjistrimit

Obligohenet i akuzuari M P që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj paushallin në lartësi prej 300 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur akuzë PP.nr.25/2015 të datës 09.06.2015, kundër të akuzuarve M P, M B, Sh B, për shkak të veprës penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge në bashkëkryerje nga neni 273/1 lidhur me nenin 31 të KP-

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka dekluar se pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, pas administrimit të provave dhe dëgjimit të pandehurve në tërësi është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë duke shtuar se qeset të cilat janë dërguar në ekzaminim kanë pasur mbetje të substancës narkotike të llojit marijuanë dhe atë në qesen e plastikës me ngjyrë të bardhë me mbishkrinin “ ” ka pasur substancë narkotike me ngjyrë të gjelbër me peshë neto prej 128,77 gr. në qesen plastike të tejdukshme e evidentuar dëshmia 1.1 ka pasur substancë narkotike të llojit marijuanë 0.22 gr., në një qese tjetër të evidentuar dëshmia 1.2 ka pasur 0.22 gram mariuanë. Në dëshminë 1.3, qese plastike e tejdukshme e grisur është gjetur 0.72 gram mariuanë, në dëshminë 2. Në qesen plastike të hapur me ngjyrë kuq e zi, me mbishkrim Ceylon Tea ka pasur substancë narkotike të llojit mariuanë 36.01 gram, po njashtu edhe në dëshmitë nr. 3.1, 3.2, 4, 5, 6, 7 dhe 8 ka pasur mbetje të substancave narkotike. Pas ekzaminimit të gjithë këtyre dëshmive ka rezultuar se sipas karakteristikave morfoloژike dhe përbërjes kimike të gjitha këto dëshmi përmbytjanë tetrahidrokanabinol me peshë neto të përgjithshme prej 167.39 gramësh, ndërsa kanabisë është bimë narkotike e kategorizuar në tabelën 1 të Ligjit për barna narkotike, substanca psikotrope dhe prekursorë.

Nga foto dokumentacioni i bërë gjatë fotografimit të automjetit, rezulton se në bagazhin e automjetit nuk ka qenë e vendosur vetëm një qese ashtu si ka dekluar M B por në bagazhin e automjetit kanë qenë të shpërndara më tepër se një qese, edhe atë jo vetëm me ngjyrë të zezë, por edhe me ngjyra tjera ashtu si është përshkruar më lartë, çka do të thotë se këto qese nuk i ka mbledhur i pandehuri M B në rrugë në afërsi të picerisë “ ” duke menduar se janë mbeturinat që kanë rënë nga bagazhi i tij, por në këto qese kanë qenë të vendosura substancat narkotike të llojit marijuanë, të cilat janë shpërndarë më herët te persona të panjohur.

Të pandehurit M P dhe Sh B kanë mohuar ta kenë ditur që në bagazhin e automjetit ka pasur substancë narkotike, ndërsa M B jo ashtu ka mohuar ta ketë ditur se brenda qeses së najlonit janë disa qese në brendësinë e të cilëve ka narkotikë.

Foto dokumentacioni i bërë në vendin e ngjarjes tregon se pjesës së deklaratës të M<sub>1</sub> B<sub>1</sub>, me të cilën deklaron se nuk ka ditur përbajtjen e qeseve në momentin kur i ka futur qeset në automjet, s'duhet ti falet besimi nga se gjendja faktike e vërtetuar në vendin e ngjarjes ndryshon në tërësi nga përshkrimi i të pandehurit M<sub>2</sub> B<sub>2</sub>. Edhe deklaratës së të pandehurve M<sub>3</sub> P<sub>1</sub> lhe Sh<sub>1</sub> B<sub>3</sub> që ata nuk kanë ditur se çka ka në bagazh, nuk duhet t'i falet besimi, nga se tërë ditën e kanë pasur automjetin në përdorim.

Deklaratat e të pandehurve lidhur me mënyrën se si gjoja i kanë ndërruar automjetet, janë shumë kundërthënëse me njëra tjetrën, të tre të pandehurit janë njohur në mes vete dhe që të tre janë pajtuar me veprimet e njëri tjeterit, ponjashtu edhe me pasojën si të veprimeve të veta ashtu edhe të veprimeve të njëri tjeterit. Narkotiku i përshkruar është gjetur në posedim të M<sub>4</sub> P<sub>2</sub> lhe Sh<sub>2</sub> B<sub>4</sub> në momentin e kontrollit rutinor të automjetit nga ana e Policisë. Mbetjet e narkotikut nëpër të gjitha qeset e najlonit tregon faktin se në ato qese ka pasur narkotik, pra ato qese kanë qenë mbështjellëse të narkotikut, e pasi që ai narkotik nuk është gjetur, e tëra është tregues se është shpërndarë më herët, dhe se këta të tre të pandehur kanë marrë pjesë në shpërndarjen dhe kanë poseduar narkotik me qëllim të shitjes.

Nga të lartcekurat konsideroj se në veprimet e të pandehurve M<sub>5</sub> P<sub>3</sub> M<sub>6</sub> B<sub>5</sub> dhe Sh<sub>3</sub> B<sub>6</sub> qëndrojnë elementet esenciale të veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga nen 273 par. 1 të KP-së e lidhur me nenin 31 të KP-së, për të cilat janë përgjegjës në aspektin penal-juridik. Andaj propozoj që Gjykata të njëjtit ti shpall fajtor për këtë vepër penale në bashkëkryerje dhe t'ua shqiptoj dënimet e parapara me ligj.

Në kuptim të dispozitës së nenin 273 par. 5 të KP-së propozoj që narkotiku i përshkruar nën pikën I të aktakuzës të konfiskohet, po ashtu të konfiskohet edhe automjeti Opel Kadet, me targa të regjistrimit ( ), si mjet që është shfrytëzuar për transportin dhe shpërndarjen e substancave narkotike.

Mbrojtësi i të akuzuarit M<sub>7</sub> P<sub>4</sub> avokati A<sub>7</sub> H<sub>7</sub> në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar, si në procedurën hetimore ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor prokuroria e shtetit nuk ka mundur të bindë e as të provon në mënyrë të pa dyshimtë se ekzistojnë prova të duhura dhe të mjafueshme për ta shpallur fajtor të akuzuarin. Prokurori i shtetit edhe në fjalën përfundimtare nuk është marrë me analizimin detale të elementeve të veprës penale për të cilën e akuzon të mbrojturin tim M<sub>8</sub> P<sub>5</sub> si dhe nuk ka shtjelluar sa duhet e si duhet gjendjen e fakteve të kësaj çështje penale, andaj kjo mënyrë e akuzimit nga ana e Prokurorisë së Shtetit është në kundërshtim me nenin 48 të KPPK-së dhe ligjin mbi prokurorin e shtetit neni 7, sepse prokurori duhet që me përkushtim më të madh, maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërteton si faktet që shkojnë kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij. I akuzuari M<sub>9</sub> ka qenë në paraburgim nga data 22.02.2015 deri me datën 06.03.2015 ku i është ndërprenë me aktvendimin Ppr.nr.24/2015 me datën 06.03.2015 për të vazhduar me masën lajmërimi në Stacionin Policor gjeri me datën 23.03.2015. I njëjti në polici është mbrojtur e drejt kjo e parapamë me ligj për tu deklaruar në Prokurori me datën 02.03.2015 në të cilën deklaratë ka sqaruar në detale tërë rrjedhën për ngjarjen e ditës kritike duke filluar nga ora 15:00h të datës 21.02.2015 deri në momentin e ndalimit nga Policia e Kosovës Stacioni Policor në Prizren. Të gjitha këto deklarime Prokuroria i ka verifikuar edhe me rastin e marrjes në pyetje të bashkakuzuuarve por se edhe përkundër faktit se Substanca narkotike e gjetur në bagazhin e veturës me shënim si në shkresat e lëndës e të cilën veturnë i mbrojturi im e kishte në shfrytëzim nga i bashkakuzuari M<sub>10</sub> B<sub>10</sub> e i cili ka pohuar faktin se kjo qese e zezë e najlonit është e tija dhe se ai e ka vendosur në bagazh për të cilën ka treguar se ku dhe përsë e ka marrë,

Prokuroria e shtetit vazhdon të mbetet pranë aktakuzës me pretendim se ka prova materiale të mjaftueshme, ekziston Maksima juridike se “ku kemi prova materiale fjalët janë të pakta” ose “ti me sjell provat unë të jap drejtësinë”, andaj ne të gjithë jemi dëshmitar se prokuroria e shtetit nuk ka sjell asnjë provë materiale e cila do të ndërlidhte të mbrojturin tim me kryerjen e veprës për të cilën edhe akuzohet.

I mbrojturi im me rastin e dhënies së mbrojtje së tij me datën 29.11.2016 në shqyrtimin gjyqësor në detale ka sqaruar dhe ka shpjeguar tërë situatën e asaj dite duke mos fshehur asgjë i cili ndër të tjera ka dekluaruar se është e vërtetë që ditën kritike kam pasur në posedim-shfrytëzim veturën e markës Opel kadet me targa të regjistrimit . . . . . të cilën e ka marrë nga këtu i pandehuri Meriton Bajrami, dhe se nuk e ka kontrolluar as brendinë e veturës e as bagazhin e saj. I njëjti ka lëvizur nga Prizreni në Gjonaj, nga Gjonaj në Prizren, pastaj në Gjakovë, pastaj Gjakovë Graqanicë, e nga Graqanica në Nashec dhe se me tu kthyer për Prizren ndalet nga Policia e cila pas kontrollit rutinor kërkon të hapet bagazhi dhe se me të vërejtur që është një qese e najlonit e zezë e njofton policinë se nuk është e tija dhe i kërkon policisë ta thérret pronarin e veturës këtu M. B. , me leje të Policisë e thrret M. B. dhe i kërkon që të vijë në vendin ku edhe është ndaluar nga Policia, Meriton Bajrami shkon edhe pse ishte vonë dhe i thotë policisë se vetura dhe qesja në bagazhin e veturës është e tija. M. B. dhe Sh. B. në deklaratat e dhëna në Prokurori me datën 02.03.2015, por edhe në seancë e datës 07.02.2017 para trupi gjykues në seancë gjyqësore ka dekluaruar njëjtë lidhur me rastin e ditës kritike. Lidhur me këto rrethana, Trupi Gjykues duhet t’ia fal besimin dëshmisë dhe mbrojtjes së M. P. Është dhënë para prokurorisë dhe tani në shqyrtim gjyqësor kryesor ku ka dekluaruar se fare nuk ka pasur dijeni se çka ka në bagazhin e automjetit. Në fund ka dekluaruar se, duke u bazuar në deklaratat e të bashkakuuarve, dëshminë e të mbrojturit tim, si dhe provave tjera të administruara gjatë seancave kryesore, konsideroj se Prokuroria e Shtetit nuk ka arritur të vërtetoj përtej dyshimit të bazuar fajësinë e të mbrojturit tim lidhur me veprën penale për të cilën edhe është ngarkuar, gjegjësisht nga analizimi i të gjitha fakteve relevante në këtë çështje juridiko penale vijmë në përfundim nga veprimet e të mbrojturit tim ditën kritike nuk është përm bushur asnjë element i veprës penale për të cilën akuzohet M. P. Duke propozuar që në kuptim të nenit 364 paragrafi 1 pika 1.3 të akuzuarin M. P. ta e liron nga akuza për veprën penale Blerja, Posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e substancave narkotike, psikotrope dhe analoge nga neni 273 parag. 1 e lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit M. B. avokati B. N. në fjalën e tij përfundimtare ka dekluaruar se, lidhur me pretendimet e akuzës të njëjtin në përbajtje dhe në cilësim kemi kundërshtuar edhe më parë por për shkak të rrethanave se gjykata ka konsideruar që të gjitha rrethanat dhe veprimet duhet të shqyrtohen në shqyrtim këto kundërshtime në atë fazë të procedurës janë refuzuar. Duke pasur parasysh se tani ka përfunduar procedura e provave më duhet të ritheksojë se ato kundërshtime në fakt janë vërtetuar plotësisht, sidomos sa i përket përshkrimit faktik të në dispozitiv të aktakuzës në të cilën më shumë paraqiten veprimet të cilat absolutisht nuk kanë lidhje me cilësimin juridik se sa veprimet të cilat duhet të jenë në lidhshmëri me pretendimet e akuzës. Si për shembull në aktakuzë përmendet veprimi se njëri prej të akuzuarve furnizon automjetin me karburante dhe paraqet lëvizjen e dy të akuzuarve në këtë automjet duke mos dhënë asnjë, së paku, indikacion se çfarë lidhshmërie ka kjo lëvizje me cilësim juridik përkatesisht me pretendimin e posedimit të transportit të shpërndarjes të substancave narkotike nga neni 273 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KP-së. Gjithashtu në përshkrimin faktik pretendohet se sasia e narkotikut prej 167,39 gram ka qenë e shkapërderdhur nëpër qese të najlonit ashtu si numërohet në përshkrimin faktik të aktakuzës, përkatesisht në 12 qese, e në fakt këtë pretendon të arsyeton në një mënyrë se të gjitha këto qese kanë qenë në

ekzaminim dhe se gjatë ekzaminimit në to janë gjetur sasitë të caktuara në gramazhë shumë të vogël të narkotikut për të cilën bëhet fjalë në këtë çështje penale juridike duke harruar faktin se vetakuza tregon se këto qese kanë qenë të futura njëra me tjetërën dhe se sipas akuzës qesja në të cilën ka qenë i vendosur sasia e caktuar e narkotikut ka qenë në brendi të këtyre qeseve dhe se deri sa ka qëndruar ajo qese në brendi të këtyre policia ka detyruar njërin prej të akuzuarve të hapë të njëjtën dhe ashtu në atë gjendje çka është bërë më tutje nuk përshkruhet dhe vihet në dyshim se gjatë manipulimit me këse të pretenduara ka ardhur edhe deri te shkapërderdhja e sasisë e cila është gjetur në një qese, pra këto pretendime të paraqitura në aktakuzë vetëm vërtetojnë se e njëjta, pra aktakuza, manipulon me supozime të cilat në fakt më pastaj pretendon të mbulon me një veprim e cila emërohet si ekspertizë duke anashkaluar të gjitha veprimet tjera të cilat duhet të paraprijnë ekspertizës dhe analizave përkatëse.

Gjatë procedurës së provave është tentuar të administrohen disa prova me të cilat kryesisht janë të lidhur me veprimet të caktuara të policisë të cilat veprime, nëse kihet parasysh dokumenti i cili na tregon se është bërë sekuestrimi i përkohshëm i sendeve, shihet qartë se këto veprime jo vetëm që nuk kanë qenë të kujdeshme dhe të duhura në suazat të njoftimeve të domosdoshme për të siguruar prova por kanë qenë shumë të mangëta, kjo për arsy se nga ky vërtetim pa mëdyshje rrjedhë se substanca narkotike nuk është konfiskuar nga cili do prej të pandehurve por është konfiskuar nga një i dyshuar me emrin F. B. pra si mund të pretendohet që ekziston prova mbi sekuestrimin kur kjo nuk ka të bëj me të pandehurit por ka të bëj me një të dyshuar krejtësisht tjetër. Sa i përket të pandehurit M. B. në asnjë mënyrë prokuroria nuk ka mundur të vërteton që ai ka qenë në çfarëdo mënyre i implikuar e çfarëdo posedimi i çfarëdo sasie të narkotikut jo vetëm nëse kihet parasysh kjo çka thash lidhur me vërtetimin e lartë përmendur por edhe nga provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit.

Këto të gjitha sepse kihet parasysh se e tëra pretendon të bazohet në deklaratat e të pandehurve duhet të theksojë se në këtë rast nuk mund të merret çfarëdo vendimi që do të bazohej në këto deklarata e në mungesë të provave të duhura të cilat kishin me vërtetua së paku posedimin e assesi transportin, shitjen e tjera të sasisë narkotike konsideroj se trupi gjykues do të merr vendim lirues në mungesë të provave.

Sa i përket propozimit me të cilën kërkohet sekuestrimi i automjetit më duhet të përkujtoj se në rastin konkret janë shkel dispozitat e kreut XVIII të KPP në të cilën do e mos parashihet ndërmarrja e veprimeve të duhura nga ana e prokurorit në momentin e propozimit për sekuestrim në rastet kur kemi të bëjmë me pronën e personit të tretë i cili në këto raste duhet do e mos të jetë i informuar për një propozim të këtillë për të ndërmarr veprimet me të cilat e mbron të drejtat e tija pronësore në procedurën penale gjegjësisht në procedurën e veçantë në sekuestrimin e gjësendeve pa marr parasysh a kemi të bëjmë me sekuestrimin e përkohshëm se ky propozim duhet të refuzohet tanë për tanë dhe të mundësohet personit të tretë që të mbron të drejtat e veta pronësore.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. B. avokati R. K. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se sipas dispozitës së nenit 273 par. 1. Të KP-ës kryes i kësaj vepre penale mundet me qenë kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje, substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burim, prej (2) deri në tetë. Ndaj rezulton se si elemente përbërëse të kësaj vepre penale janë kryerësi duhet me qenë blerës ose me qenë poseduës i narkotikëve dhe qëllimi i kryerësit duhet me qenë shitja, shpërndarja, ose ofrimi për shitje. Nga provat e administruara gjatë shqyrtimeve kryesore, me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar fakti se i akuzuari Sh. B. është nxënë ose

është pa duke ble, apo në ndonjë mënyrë tjetër nuk është vërtetuar se kishte ble narkotik, dhe gjithashtu me asnjë provë të vetme gjatë gjithë shqyrtimeve kryesore, nuk është vërtetuar se i akuzuari Sh<sup>i</sup> B<sup>..</sup> ishte në posedim të narkotikëve të konfiskuar apo dikujt tjetër i kishte ofruar për shitje. I njëjtë në të gjitha intervistat e tija, si në polici, në prokurori dhe në shqyrtimin kryesor, ka dekluaruar se ditën kritike të dat. 21.02.2015 në orët e pasdites ishte takuar me të akuzuarit tjerë M<sup>..</sup> P<sup>..</sup> dhe M<sup>..</sup> B<sup>..</sup> M<sup>..</sup> ai e njihte edhe më parë sepse ishin të një lagjeje ndërsa M<sup>..</sup> e kishte njojur (3) muaj ditë para këtij rasti, dhe në këtë takim, M<sup>..</sup> nga M<sup>..</sup> kishte marrë veturën e tij të markës "Opell Kadet" me targa regjistrimi , dhe me të njëjtin së pari kishin shkuar deri në fshatin Nashec, ku edhe e kishin marrë një shok të M<sup>..</sup> me emrin D<sup>..</sup> dhe nga këtu kishin shkuar në Gjakovë ku e kishin marrë të dashurën e D<sup>..</sup> dhe të katërtit kishin shkuar deri në fshatin Graçanicë, ku atje M<sup>..</sup> kishte pasur punë dhe pastaj janë kthyte përsëri në Prizren. Fillimisht ishin nisur për në fshatin Nashec për të dërguar personin me emrin D<sup>..</sup> ndërsa në rrugë para se me mbërrit në fshatin Nashecë i akuzuari Sh<sup>i</sup> B<sup>..</sup> ka zbritur, dhe ka pritur deri sa është kthyer M<sup>..</sup> me automjet, diku rrëth orës i 00:5 të mëngjesit. Në atë momente atypari kalon një patrullë policore dhe pasi vie M<sup>..</sup> me automjet hyp në automjet dhe pas një kohe të shkurtër ndalothen nga policia. Policia kontrollon automjetin urdhëron M<sup>..</sup> ta hap bagazhin e automjetit dhe në bagazh të automjetit policia gjen një këse të dyshimitë dhe pasi e zbulon gjen se brenda kësaj këse kishte pasur edhe shumë këse tjera plastike ndërsa në njëren prej tyre kishte pasur substancë narkotike të llojit marijuan. Pasi që automjeti ishte i M<sup>..</sup> i akuzuari M<sup>..</sup> e thërrret me telefon M<sup>..</sup> njoftohet nga policia për qesen e gjetur i cili pranon se kjo qese është e tij, të cilën për disa ditë e kishte gjetur në rrugë të cilën e kishte hudhur për mbeturina të cilën përsëri e kishte marrë dhe e kishte futur në bagazh të automjetit: M<sup>..</sup> nuk i kishte treguar M<sup>..</sup> dhe Sh<sup>..</sup> po për qese që e kishte pasur në bagazh të automjeti dhe M<sup>..</sup> me Sh<sup>..</sup> fare nuk kishin ditur se në bagazh të automjetit ka diçka të tillë.

I akuzuari Sh<sup>i</sup> B<sup>..</sup>, akuzohet se veprën penale për të cilën akuzohet e ka krye në bashkëkryerje edhe me të akuzuarit tjerë në këtë rast me të akuzuarin M<sup>..</sup> P<sup>..</sup> dhe me të akuzuarin M<sup>..</sup> B<sup>..</sup>. Dispozita e nenit 31. Të KP-së lidhur me bashkëkryerësit thotë: Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësishët duke i kontribuar kryerjes së saj ose në ndonjë mënyrë tjetër. Pra sipas kësaj dispozita ligjore për të qenë bashkëkryerës i një vepre penale, bashkëkryerësit duhet të veprojnë së bashku. Kusht themelor për të qenë bashkëkryerës i një vepre penale është se bashkëkryerësit paraprakisht duhet të jenë marrë vesh për veprën penale, të kenë krijuar planin e veprimit apo së paku në ditën kur vepra e tillë kryhet. Pra për të ekzistuar bashkëkryerja duhet plotësuar kumultivisht dy elementet qenësore. 1 Lidhja subjektive që do të thotë vendimet e përbashkëta të kryerësve të veprës penale, dëshira dhe vullneti i tyre për të krye veprën penale dhe 2 Lidhja objektive që nënkopoton veprimet e përbashkëta apo kryerja e veprës penale.

Nga provat e administruara me asnjë provë të vetme apo me asnjë fakt, nuk është vërtetuar se i akuzuari Sh<sup>i</sup> B<sup>..</sup> ka pasur një marrëveshje paraprake, me të akuzuarit tjerë, apo një marrëveshje e tillë është krijuar në ditën kritike kur është marrë automjeti nga i akuzuari M<sup>..</sup> B<sup>..</sup>. I akuzuari Sh<sup>i</sup> B<sup>..</sup> nuk ka qenë në dijeni, se do të kryejnë veprën penale për të cilën akuzohen. Ai nuk ka ditur se fare në bagazhin e automjetit në të cilin ishte vetëm pasagjer ndodhet substanca narkotike, apo ka diçka të ndaluar me ligj. Ai këtë e ka kuptuar vetëm atëherë kur policia i ka ndaluar dhe kur policia ka kontrolluar automjetin në të cilën ai ishte pasagjer. Nga kjo rezulton se i akuzuari Sh<sup>i</sup> B<sup>..</sup> nuk ishte bashkëkryerës i veprës penale për të cilën akuzohet sepse nuk kishte dijeni për veprën penale, nuk kishte pasur

kurrfarë marrëveshje paraprake me të akuzuarin M<sup>c</sup> B<sup>e</sup>, dhe se nuk i kishte ndërmarrë kurrfarë veprime inkriminuese me të cilën do të dëshmohet fajësia e tij.

I akuzuari M<sup>c</sup> P<sup>e</sup> në mbrojtjen e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me datën 21.02.2015 ka qenë në ETC-në në Prizren së bashku me Sh<sup>c</sup> B<sup>e</sup>, ku janë takuar edhe me M<sup>c</sup> B<sup>e</sup> të cilin e njihet që 4-5 viteve por me të nuk kishte ndonjë shoqëri të madhe i cili atë ditë kishte blerë një makinë për çka edhe kishte ftuar të pijnë kafe. Në vazhdim ka theksuar se i kishte 4 kerra por nuk punonin asnjëri prej tyre, makina e tij personale i ishte prishur një ditë më parë ndërsa për shkak se i kishte disa punë dhe kishte për të shkuar në Graçanicë për do dokumente i kishte thënë M<sup>c</sup> që ta qonte diku në një Renta Car që ta merrte një makinë, mirëpo M<sup>c</sup> B<sup>e</sup> vullnetarisht i kishte thënë që ta merre makinën e tij Opel Kadet. Në bisedë e sipër i akuzuari i kishte ofruar M<sup>c</sup> B<sup>e</sup> një kombi për shitje cili nuk ishte i doganuar të cilin kombi i njëjtë ia kishte lënë M<sup>c</sup> tek autolarja Xh<sup>c</sup> në A<sup>e</sup> ndërsa prej aty me makinën e M<sup>c</sup> ishte nisur për në fshatin Gjonaj që ta merre një shokë me veti për në Graçanicë. Prej Gjonajve ishte nisur për në Gjakovë që ta merrte shokun e tij D<sup>c</sup> D<sup>e</sup> i cili nuk ishte në Gjonaj, ka shkuar në Gjakovë e ka marrë shokun e tij dhe është kthyer në Prizren në lagjen Arbana ku kanë pirë kafe te Spahia Petroll ndërsa deri sa ishin duke pirë kafe e kishte njoftuar një vajzë nga Graçanica me emrin T<sup>c</sup> se i njëjti mund t'ia dërgonte dokumentet për një plak. Prej aty së bashku me Sh<sup>c</sup> B<sup>e</sup>, D<sup>c</sup> D<sup>e</sup> si dhe një vajzë nga Gjakova e dashura e shokut të tij D<sup>c</sup> e të cilës nuk ia dinte emrin ish nisur për në Graçanicë ku kanë qëndruar gjysmë ore përsëri prapë janë kthyer në Prizren. Shoku i tij D<sup>c</sup> D<sup>e</sup> i cili kishte shkuar së bashku me të deri në Graçanicë të cilin e kishte marrë për të përkthyer pasi që vetë nuk e dinte gjuhën serbe, ka kërkuar që ta dërgonte deri në fshatin Nashec tek Villat ndërsa para se të mbrrinin tek Villat shoku i tij i akuzuari Sh<sup>c</sup> B<sup>e</sup> i cili gjatë gjithë kohës ishte me ta ka kërkuar që të dilte nga makina, për arsyet që të mosh shihnin prindët e tij duke shkuar te Villat, i njëjti ka dalë nga makina ndërsa shokun e tij D<sup>c</sup> e kishte dërguar deri te Villat pastaj është kthyer deri te vendi ku ishte duke pritur Sh<sup>c</sup> B<sup>e</sup> të cilin e merr në makinë e i cili tregon se kishin dalë policia dhe pasi që kanë vozitur diku 100-200 metra nga prapa ka pa që policia ka lëshuar alarmin prapa tyre për shkak është edhe ndalur. Policia e kishte kërkuar dokumentet dhe e kanë pyetur se a kanë diçka në makinë dhe kanë kërkuar që ta hapte bagazhin e veturës, i akuzuari ka hapur bagazhin e veturës dhe aty në bagazh ka pa një qese plastike me ngjyrë të zezë, polici e kishte urdhëruar që ta hapte atë qese por i akuzuari kishte thënë se më fal kjo nuk është makina ime dhe i kishte thënë do ta thërrret pronarin e makinës me telefon. I akuzuari telefonon M<sup>c</sup> duke i thënë se i kishte ndalur policia i kanë kërkuar që ta hapte bagazhin dhe në bagazh kishte një kese M<sup>c</sup> kishte thënë se është një kese e zezë dhe është bërllog ai ka kërkuar që të bisedoj me policinë me telefon mirëpo polici nuk ka pranuar kështu që M<sup>c</sup> ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe iu kishte thënë policëve se makina ishte e imja dhe qese në bagazh është e imja. Policia kanë marrë M<sup>c</sup> dhe kanë futur në veturë të policisë e që në ndërkohë M<sup>c</sup> i ka dalur nga vetura e policisë dhe i kishte thënë "mos u tut se nuk është kurgjo" pastaj kanë ardhur njësia e antidrogës dhe kanë marrë qesen dhe e kanë arrestuar.

Veturën e M<sup>c</sup> e kishte marrë përafërsisht rreth orës 14:00 dhe 17:00 mbas dite ndërsa policia e kishte ndalur diku pas orës 23:00 kur edhe i kanë kontrolluar gjithashtu edhe në trupë, atë natë me veti kishte 60-70 euro mirëpo këto të holla nuk i janë konfiskuar nga policia. Në vazhdim ka deklaruar se të akuzuarin Sh<sup>c</sup> B<sup>e</sup> e ka kojshi dhe se shqërohet me të, i njëjti është diku 20 vjeçar me të takohet së paku 10 herë në ditë dhe i njëjti i ka bërë shoqëri për të shkuar në Graçanicë. Në vazhdim është mbrojtur se në momentin kur e ka hapur bagazhin e Opel Kadetit ka parë se aty ka qenë një qese e zezë e bërllogut në të cilën qese ka pasur shumë qese tjera e në fund të qeses ka qenë substanca e cila ka rezultuar se është marijuanë, ndërsa diçka tjetër pos kësaj qese në bagazh nuk ka pasur, tapiceria e bagazhit ka qenë e pastër, duke

shtuar se në momentin kur është bërë bastisja e automjetit prezent kanë qenë vet i akuzuari së bashku me dy të akuzuarit tjere M. B. si dhe dy policë dhe pas bastisjes është bërë fotografimi i automjetit ndërsa automjeti është tërhequr me marimangë procesverbal me shkrim është bërë pasi që kanë shkuan në Stacionin Policor. Atë ditë të akuzuarit i ishin marrë dy telefona një Nokia dhe një Sony Ericson. Gjatë dhënies së mbrojtjes së tij mbrojtësi i të akuzuarit Sh. L. B. avokat R. G. të akuzuarin M. P. e përball me deklaratën e tij të dhënë në Prokurori duke ia lexuar procesverbalin HP.25/2015 i pyetur nga mbrojtësi se në deklaratën e tij të dhënë para prokurorit ka deklaruar se "së bashku me Sh. L. B. u nisëm për në Gjonaj të Hasit nga ku e morrën shokun tim D. D. e prej fshatit Gjonaj u nisëm në Prizren dhe së bashku kemi pirë kafe, në bisedë e sipër me D. L. u nisëm për në Gjakovë..." ndërsa sot ka deklaruar ndryshe i pyetur se cila është e vërteta i akuzuari është mbrojtur e vërteta është ajo që kam deklaruar para Prokurorit. I akuzuari i pyetur se a e ka prekur qesen në praninë të policisë është mbrojtur se po e ka prekur vetëm qesen e jashtme ndërsa kur i ka parë qeset e tjera i ka thënë policit se unë nuk i preki më shumë ndërsa i përballur me deklaratën e dhënë në prokurori ku në faqen e fundit të kësaj deklarate në paragrin e parë e kishte deklaruar se "policia më thanë që të nxjerrë sendet nga ajo qese, unë e hapa qesen e futa dorën brenda dhe një nga një fillova me nxjerrë sendet e që përbëheshin prej qeseve të najlonit, pra ishin qese të zbrazëta të najlonit e në fund e pash që ishte diçka si bari" i akuzuari është mbrojtur se e vërteta është kjo që ka deklaruar në Prokurori duke shtuar se është e vërtetë se e ka futur dorën në qese por kur e ka vërejtur "barin" atëherë i ka larguar duart dhe i ka thënë policit unë nuk preki më asgjë, i pyetur si e ka ditur se në fund të qesesë është "bari" i akuzuari është mbrojtur se ajo shihet se çka është nuk mundem me thanë se nuk di se çka është, pasi që e njoh se çka është edhe peshën e di se çfarë peshe ka dhe është e pabesueshme që unë të kem me veti atë.

Duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit M. B. gjykata konstatoi se i njëjti është munduar që t'i ikë përgjegjësisë penale. Në të vërtetë i njëjti nuk e ka mohuar se ditën kritike me datën 25.02.2015 në orën 00:5 minuta është ndalur nga policia dhe pas kontrollit në bagazhin e veturës të cilën e ngiste ai vet, është gjetur substancë e llojit marijuanë e futur në një qese të zezë të cilën nuk e ka pranuar se është e tija. Gjithashtu nuk e ka mohuar se këtë veturë e kishte marrë-ndërruar me M. B. edhe pse i njëjti fillimisht deklaron se këtë veturë e kishte huazuar nga M. K. për shkak se katër veturat e tija ishin të prishura e pastaj deklaron se e kishte ndërruar me M. B. me një Kombi. I akuzuari nuk e ka mohuar se këtë veturë e kishte marrë diku pas orës 14:00 dhe e kishte mbajtur deri në ora 00:5 minuta pas mesnate kur edhe e ndalin policia, dhe gjatë gjithë kësaj kohe ishte vetëm ai që e kishte pasur në posedim dhe përdorur këtë veturë dhe gjatë kësaj kohe kishte shkuan në disa vende si në fshatin Gjonaj për tu kthyer në Prizren pastaj në Gjakovë, në Graqanicë dhe përfundimisht në fshatin Nashec.

I akuzuari M. B. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se të akuzuarin M. B. është njeh qe 2 vjet para këtij rasti dhe se i njëjti merret me shitblejen e tokave dhe kerreve, në këtë kohë i akuzuari ishte duke punuar shef i sigurimit në ETC. Veturën Opel Kadet e kishte pasur dy javë para ditës kritike, të njëjtin veturë e ka përdorur njëherë edhe për mbeturina dhe ate 3-4 ditë para se me ia huazuar veturën M. B. këtë veturë nuk e ka shfrytëzuar shumë pasi që e kishte edhe veturë tjetër. Natën kur e kishte ftuar me telefon i akuzuari M. B. pasi që e kishte ndaluar policia a kishte shkuan pas 40 minutash në vendin e ngjarjes pasi që i kishte thënë se ka problem me kerrin e jo diçka tjetër, aty kishte parë se gepeki i veturës ka qenë i hapur, ndërsa e kishin pyetur se dyshohet për narkotikë i njëjti i ka treguar se ai ka gjuajtur mbeturina por se çka ka në atë qese nuk e dinte pasi që veturën e kishte dhënë në ora 12:00 të ditës, lidhur me kësen është mbrojtur se disa ditë përpëra kishte hedhur mbeturina me veturë dhe se ka mundësi që ajo këse të ketë ra nga mbeturinat e tija e cila është gjetur para

picerisë Roma. Në vazhdim është mbrojtur se me M<sub>1</sub> B<sub>1</sub> është njoftuar përmes punës me të cilën e kishte kryer punët në ETC po ashtu se janë marrë vesh për ndërrimin e kombit me veturën Opel prezent ka qenë edhe Sh<sub>1</sub> B<sub>1</sub>. I akuzuari ka deklaruar se nuk i ka huazuar Opel Kadetin por marrëveshja ka qenë që t'i ndërronin veturat, normal M<sub>1</sub> me këqyr veturën time e unë me këqyri veturën e tij, atë ditë unë e kam qu dhe ka pastruar kombin pasi që e kam pastruar nuk më ka pëlqyer kështu i kam telefonuar M<sub>1</sub> dhe i kam thënë se nuk pajtohem me ndërru veturën dhe i kam kërkuar me ma kthye Opel Kadetin ka qenë ora diku rrëth 05:30-06:00 pas dite dhe më ka thënë jam larg në Gjakovë nuk mundem me u taku për momentin. Në vazhdim është mbrojtur se nuk i kujtohet se qka i ka thënë përmes telefonit të akuzuarit M<sub>1</sub> por se ditën kritike kur ka shkuar në vendin e ngjarjes policisë i ka thënë se ka mundësi që quesja të ketë qenë në bagazh por se çka ka mbrenda nuk e din. Ditën kur ia ka dhënë veturën M<sub>1</sub> prezent ka qenë edhe i pandehuri Sh<sub>1</sub> B<sub>1</sub> i cili ishte prezent edhe kur ia kishte dhënë M<sub>1</sub> veturën ndërsa nuk e ka ditur se ata janë duke shkuar në Graçanicë. Në vazhdim është mbrojtur se automjeti i cili shihet në fotodokumentacion është automjeti i tij "Opel Kadet" gjithashtu edhe çelësi i cili gjendet në shkresat e lëndës është çelësi i veturës të cilin ia ka dhënë të akuzuarit M<sub>1</sub> P<sub>1</sub>

Duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit M<sub>1</sub> B<sub>1</sub> gjykata konstatoi se i njëjti me të akuzuarin M<sub>1</sub> P<sub>1</sub> është njojur edhe më herët, ndërsa ditën kritike me të ishte takuar në ETC ku prezent ka qenë edhe Sh<sub>1</sub> B<sub>1</sub> ku edhe ishin marr vesh që me M<sub>1</sub> të bëjnë ndërrimin e veturave, veturës "Opel Kadet" dhe veturës "Kombi". Ka qenë ora 12,00 i ditës kur i akuzuari M<sub>1</sub> P<sub>1</sub> e kishte marr veturën Opel Kadet nga M<sub>1</sub> B<sub>1</sub> ndërsa i njëjti ia kishte dhënë veturën "Kombi". Gjatë asaj dite veturën e kishte shfrytëzuar i akuzuari M<sub>1</sub> P<sub>1</sub> gjatë gjithë kohës, ndërsa M<sub>1</sub> B<sub>1</sub> po të njëjtën ditë pasi që e kishte pastruar Kombin që e kishte marr nga i akuzuari M<sub>1</sub> P<sub>1</sub> i telefononte të njëjtit duke i thënë se nuk pajtohet që të nderonte veturat por i akuzuari M<sub>1</sub> P<sub>1</sub> i kishte thënë se ai gjendët në Gjakovë dhe se nuk mund të takoheshin. Po atë ditë dikur natën i kishte telefonuar i akuzuari M<sub>1</sub> dhe e kishte njoftuar se e kishin ardhur policia nga se diçka nuk është në rregull me veturën Kadet. I njëjti kishte shkuar në vendin e ngjarjes ku policia i kishin thënë se në veturë gjendej një qese e zezë, ndërsa i njëjti ka deklaruar se i kishte gjuajtur disa mbeturina por se çka ka në qese nuk e dinte, dhe se këtë veturë të akuzuarit M<sub>1</sub> P<sub>1</sub> ia kishte dhënë diku në ora 12,00 e ditës.

I akuzuari Sh<sub>1</sub> B<sub>1</sub> në mbrojtjen e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se të akuzuarin M<sub>1</sub> P<sub>1</sub> e ka në lagje me të njihet dhe shoqërohet qe 3-4 vjet dhe me të rrinë shpesh ndërsa M<sub>1</sub> P<sub>1</sub> e njeh që moti mirëpo muhabet ka filluar me të 3-4 muaj para se me ndodh ky rast kur ia kishte marrë një veturë në shërbim, me të jemi takuar në Elkos po jo edhe aq shpesh. Në vazhdim është mbrojtur se ka qenë data 21 ose 22.02.2015 ku është takuar me M<sub>1</sub> dhe me M<sub>1</sub> ka qenë diku ora 01: 00 ose 02:00 mbas dite ishin takuar në taracën e "Elkosit" në restuarant në Prizen, nuk kishin pasur ndonjë arsy për të takuar por janë vetëm pëershëndetur kur M<sub>1</sub> i kishte parë në tavolinë ishte ulur me ta. Në vazhdim ka deklaruar se ka qenë prezent kur M<sub>1</sub> e kishte marrë veturën prej M<sub>1</sub> atë ditë pasi që e kanë marrë veturën e ka ditur se ku ishin duke shkuar. Ditën kritike kur janë ndaluar nga policia bagazhin e automjetit e kishte hapur M<sub>1</sub> dhe në atë moment policia e kishin ftuar edhe të akuzuarin Sh<sub>1</sub> B<sub>1</sub> që të shikonte se çka ka në bagazh, aty kishte parë se ka pasur shumë qese, qeset kanë qenë njëra në tjetrën dhe në fund në një qese ka pasur substancë narkotike. M<sub>1</sub> e ka ftuar me telefon M<sub>1</sub> i cili ka ardhur në vendin e ngjarjes, policia e ka pyetur M<sub>1</sub> se kujt është kjo qese M<sub>1</sub> është përgjigjur quesja është e imja. Atë ditë unë kam shkuar me M<sub>1</sub> vetëm me shtetit ndërsa ai ka pasur punë lidhur me disa dokumente, në

ora 02:00 e kemi marrë makinën ndërsa udhëtimi ka zgjatur diku 8 orë kjo ka zgjatë deri në ora 23:00-24:00 kur i ka ndalë policia.

Duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit Sh... B... gjakata në tërësi ia fali besimin mbrojtjes së tije pasi që në tërësi përputhet edhe me provat tjera por edhe me deklaratat e të akuzuarve tjerë. Në të vërtetë i akuzuari Sh... B... e pranon se ditën kritike ka qenë prezent kur M... Puri dhe M... B... i kanë ndërruar veturat, i njëjtë e ka pranuar se të akuzuarin M... e njeh që një kohë të gjatë dhe shoqërohet me të ndërsa M... Baj... i d... e njeh nga Elkosi. Ditën kritike i njëjti kishte shkuar me M... vetëm për ti bërë shoqëri të njëjtë.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ka administruar edhe provat materiale dhe atë është bërë leximi i raportit të ekspertizës së Njësisë së Shkencave Ligjore – Analizat kimike, të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë nr. Ref.AKF/ datës 22.05.2015, është bërë leximi i raportit të ekspertizës të laboratorit për ekzaminimin e kompjuterëve Agjencisë së Kosovës për Forenzikë AKF datës 22.02.2015, është bërë shiqimi në fotodokumentacion, është bërë leximi në vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nr. i d... atës 22.02.2015, është bërë shiqimi në lejen e qarkullimit të veturës Kadet me targa

Nga rapporti i ekspertizës së Njësisë së Shkencave Ligjore, analiza kimike të Agjencisë së Kosovës për forenzikë me nr. referues AKF/ datë 22.05.2015 Gjykata ka vërtetuar se sipas rezultatit të ekspertimit ekzaminimi i substancës bimore me ngjyrë të gjelbërt nga dëshmitë e dërguar për ekspertizë ka treguar se është prezent kanabisi (marijuana) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), dhe se sipas konstatimit dhe mendimit përfundimtar në bazë të karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike dëshmitë përbajnjë kanabis (marijuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) pesha neto e përgjithshme 167.39 gr. Kanabisi është bimë narkotike e kategorizuar në tabelën I të ligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë, nr. 02/L-128.

Nga rapporti i ekspertizës për ekzaminim të kompjuterëve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë nr. AKF/ datës 08.05.2015 Gjykata ka vërtetuar se sipas konstatimit dhe mendimit përfundimtar në këtë ekspertizë dëshmitë janë ekzaminuar sipas procedurave teknike dhe me pajisje forenzyke të cilat e pamundësojnë ndërhyrjen në dëshmi.

Dëshmja D#A Telefon IPhone 4, modeli A1387, IMEI nuk ka mundur të ekzaminohet pasi që telefoni ka kod të sigurisë të panjohur, kurse Dëshmja D#B Telefon Nokia, modeli RM-1011, IMEI I: , dhe IMEI 2: , dhe Telefon Sony Xperia, modeli D2005, IMEI , nuk kanë mundur të ekzaminohen.

Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nr.2015-DHTN i datës 22.02.2015 vërtetohet se me datën 22.02.2015 në rrugën Nashec-Prizren nga i akuzuari M... P... janë konfiskuar përkohësisht një qese plastike, në të cilën është dyshuar se ka substancë narkotike të llojit “marijuanë”, dy telefonë mobil me ngjyrë të zezë, njëri nokia dhe tjetri Sony, veturën e tipit Kadet me ngjyrë të kuqe me targa të regjistrimit , çelësin si dhe librezën e qarkullimit të kësaj vture.

Nga leja e qarkullimit të veturës Kadet me targa nr CRA , është vërtetuar se kjo veturë ka qenë e regjistruar në emër të I S... nga Prizreni Rr”

Emrush” Nr. 6, pra nga kjo provë është vërtetuar se vetura opel Kadet nuk ka qenë e regjistruar në emër të akuzuarit M B mirëpo ka qenë në posedim të tije.

Nga të gjitha provat e administruara, si edhe nga deklaratat e të akuzuarve gjykata ka vërtetuar se ditën kritike i akuzuari M P së bashku me Sh B ishin takuar me M B ku në bisedë e sipër i akuzuari M P dhe M B merren vesh që ti ndërrrojnë veturat në mes veti dhe atë i akuzuari M P ia jep veturën “kombi” M B ndërsa ky ia jep veturën “Opel kadet” të akuzuarit M P ka qenë rrëth orës 12,00 e ditës kur veturën Opel Kadet e kishte marr në posedim dhe shfrytëzim i akuzuari M P. Pas kësaj i njëjtë me këtë veturë e që në shoqëri e kishte edhe Sh B niset për në fshatin Gjonaj, pastaj kthehet në Prizren, prej Prizrenit në Gjakovë pastaj shkon edhe në Garçanicë e pastaj kthehet në Prizren ku po atë natë në ora 00:05 minuta në rrugën lokalin Prizren –Nashec ndalet nga ana e policisë dhe të njëjtët në bagazhin e kësaj vture i gjendet narkotiku në sasi prej 167.39 gram. Pra një kohë të gjatë, gjë të cilën e pranon edhe vet i akuzuari, rrëth 12 orë këtë veturë e ka përdorur dhe shfrytëzuar i akuzuari M P e që sipas gjykatës është vërtetuar se narkotiku i gjetur në veturë ka qenë në posedim të akuzuari M P dhe se fakti se narkotiku ka qenë në qese të ndryshme tregon se ka qenë i pregaditur me qëllim të shitjes apo shpërndarjes fakt ky që është vërtetuar edhe nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve ku shihet kuartë se narkotiku është konfiskuar nga vetë i akuzuari M P

Sa i përket të akuzuarve M B dhe Sh B gjykata konstatoi se me asnjë provë nuk është vërtetuar se të njëjtët kanë kryer veprën penale që u vihet në barrë. Në të vërtetë nuk është kontestuese se vetura Opel Kadet ka qenë pronë përkatësisht në posedim të akuzuarit M B deri me datën 21.02.2015 në ora 12:00 kur edhe ia jep në posedim të akuzuarit M P e që atë ditë nga kjo kohë e deri në ora 00:05 minuta pas mesnatës kjo veturë gjatë gjithë kohës ka qenë në përdorim të akuzuarit M P. Gjithashtu nuk është kontestuese se prezent ka qenë edhe Sh B si në kohen kur është bërë ndërrimi i veturave por edhe gjatë kohës sa këtë veturë e ka pasur në posedim vet i akuzuari M P por se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti është i ndërlidhur me narkotikun e gjetur në veturë e që sipas gjykatës fakti se i njëjti ka qenë prezent duke mos e ditur se në veturë ka narkotikë nuk e bënë të njëtin bashkëkryerës në veprën penale për të cilën është akuzuar.

Sipas bindjes së gjykatës në veprimet e të akuzuarit M P, e në mënyrë më afër të përshkruar në shqiptimin e këtij aktgjykimi formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge në bashkëkryerje nga neni 273/1 lidhur me nenin 31 të KP-së,, për këtë edhe ka vendosur që të akuzuarin M P ta shpall fajtor për këtë vepra penale, pasi që në tërsësi ka gjetur se i akuzuari është juridiko penalist përgjegjës dhe se nuk ekziston asnjë rrëthanë e cila do të përashtonte përgjegjësin e tij penalo juridike.

Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat gjykata këtu të akuzuarin M P e shpalli fajtor për veprën penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273/1 të KP-së dhe të njëjtë i shqiptojë dënimin, më afër të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konform nenit 73 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënit, gjykata vlerësoi të gjitha rrëthanat të cilat ndikojnë në të njëjtin duke marrë parasysh qëllimin e dënit, të gjitha rrëthanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënit, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, kështu që dënnimi i shqiptuar do ta arrij

qëllimin e vet konform nenit 41 të KPK, dhe se këto dënlime janë në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se do të mundësoj një balancë të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale. Dënlimi i shqiptuara të akuzuarit sipas gjetjes së gjykatës është në harmoni dhe në baraspeshë me peshën e veprës së kryer penale dhe rrëthanat e kryerjes së veprave penale, dënimet e këtilla paraqiten si të domosdoshme me qëllim të arritjes së qëllimit të dënitit, me to shprehet gjykimi i shoqërisë për shkak të veprës së kryer penale dhe forcohet obligimi i respektimit të ligjit.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike është marrë në bazë të nenit 463 par.2 të KPP të Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 450 të KPP të Kosovës.

Si u cekë edhe më lart u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u murr në mbështetje të nenit 454 par.1 dhe nenit 451 par.1 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

- Departamenti i Krimeve të Rënda-

P.nr.94/2015, me datë 09.02.2017

Procesmbajtësja,  
Birsen Kume

Kryetari i trupit gjyques,  
Skender Çocaj

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë nëpermjet kësaj Gjykatë.